

V E N D I M
Nr.98, datë 21.2.1995

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.461, DATË
3.10.1994 “PËR RRITJEN E PENSIONEVE”**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.461, datë 3.10.1994, të bëhen këto shtesa:

- Në shkronjën “b” të pikës 1, pas fjalës “150 lekë në muaj”, shtohen fjalët “por të mos kalohet shuma 3840 lekë në muaj”.

- Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“Për invalidët e Luftës, përveç rritjes që pëson pensioni i tyre, shtesa mujore mbi pensionin e invaliditetit rritet në masën 150 lekë në muaj”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.10.1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi